

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Isa Kelmendi, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit – kundër paditurit Sh.p.k. “O.” në ..., të cilin e përfaqëson T. B., avokat nga Gjakova, kundër të paditurit-kundër paditësit Sh.a. “B. P.” në ..., të cilin e përfaqëson S.Z., avokat nga Peja, për shkak të kompensimit të dëmit vlera e kontestit 49.716,58 €, duke vendosur lidhur me revizionin e paditësit-kundër paditurit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AE.nr. 413/2012 datë 22.12.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur më 7.6.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit-kundër paditurit i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AE.nr. 413/2012 datë 22.12.2014.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë, C.nr.28/2011 datë 2.4.2012, nën pikën I të dispozitivit refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia nga padia e paditësit-kundër paditurit Sh.p.k. “O.” në ..., që të detyrohet i padituri-kundër paditësi Sh.a. “B. P.” në Pejë, të ia kompensojë dëmin dhe fitimin e humbur në shumë prej 49.716,58 €, me kamatë ligjore prej 3.5% duke filluar prej 15.1.2011, për shumën prej 24.000,00 € ndërsa prej 15.1.2012 për shumën prej 25.716,58 € e deri në pagesën definitive dhe t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij

aktgjykimi. Nën pikën II të dispozitivit aprovohet si e bazuar kërkesa nga kundërpadia e të paditurit-kundër paditësit Sh.a. “B. P.” në ..., dhe detyrohet i padituri-kundër paditësi Sh.p.k. “O.” në ..., që të paditurit-kundër paditësit t’ia paguajë borxhin në shumë prej 49.770,13 €, me kamatë vjetore sipas normës prej 3,5% duke filluar nga data 2.11.2010 e deri në pagesën definitive dhe t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1.532,00 €, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AE.nr.413/2012 datë 22.12.2014, nën pikën I të dispozitivit refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit-kundër paditurit dhe aktgjykimi i Gjykatës Ekonomike Prishtinë, C.nr.28/2011 datë 2.4.2012, për pjesën refuzuese të kërkesëpadiisë vërtetohet. Nën pikën II të dispozitivit pranohet ankesa e paditësit e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të Qarkut Prishtinë, C.nr. 28/2011 datë 2.4.2012 dhe lënda për pjesët aprovuese të këtij aktgjykimi i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë përkitazi me pjesën I të dispozitivit me të cilin është vërtetuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, paditësja ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të LPK dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të ndryshohen të dy aktgjykimet e shkallës më të ulët nën pikën I të dispozitivit (pjesën refuzuese) dhe kërkesëpadiia e paditësit të aprovohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedura Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion dhe gjeti se:

Revizioni i paditësit është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në bazë të kontratës nr. ..., të datës ..., palët ndërgjyqëse kanë qenë në raport detyrimor kontraktues sipas të cilit e paditura-kundër paditësja si shitëse do të shes paditësit-kundër paditurit mall-pije, birra dhe pije joalkoolike, ndërsa paditësi-kundër padituri për mallin e marrë do t’ia paguajë çmimin sipas çmim orës

së përcaktuar. Padiësja ka qenë e obliguar që mallin e pranuar të paguajë në afat prej 20 ditësh, pas pranimit të faturës ose me avancë se paditësi ka qenë i obliguar pas çdo pranimi të mallit të rij t'ia kthejë të paditurës ambalazhin nga furnizimi paraprak. Padiësja nuk është përmbytur kontratës ashtu që nuk ka deponuar në emër të avansit shumën e caktuar të parave të paraparë me kontratë dhe në afatin prej 20 ditësh nuk ka bërë pagesën e faturave të arritura për pagesë dhe në këtë mënyrë ka rënë në vonesë me pagimin e borxhit në shumë prej 158.711.73 €. E paditura për shkak të mos respektimit të kushteve të pagesës së mallit e ndërpreu kontratën e lartcekur me paditësen. Padiësja duke konsideruar se nuk i ka dhënë shkas të paditurës për shkelje të kontratës meqenëse në ndërkohë e përmbytur pothuajse në tërësi borxhin ndaj të paditurës, parashtron padinë për kompensimin e dëmit me theks të veçantë se përmbyshja në afat e detyrimit kontraktues për pagimin e çmimit nuk është kusht esencial i kontratës. Nga ana tjetër e paditura parashtron padinë për borxh në shumë prej 7.610,37 €, në emër të borxhit të mbetur si dhe kundër vlerën e ambalazhit në shumë prej 42.160,15 € në përgjithësi në shumën prej 49.770.13 € dhe pasi bëhet bashkimi i procedurës në këtë çështje juridike padia e të paditurës është trajtuar si kundërpadi gjer sa e paditura si kundër paditëse.

Duke u bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike Gjykata Ekonomike e Qarkut Prishtinë, e refuzon si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit-kundër paditurit ndërsa kërkesën nga kundërpadia e të paditurës-kundër paditëses e aprovon duke vendosur më afërsisht të përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka gjetur se ankesa e paditësit për pjesën refuzuese të kërkesëpadiës është e pabazuar dhe në këtë pjesë e vërteton aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Mirëpo, sa i përket pikës II (pjesës aprovuese) të kërkesës nga kundër padia gjen se ankesa e paditësit është e bazuar dhe në këtë pjesë e prish aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë duke vendosur si në dispozitiv. Përkatësisht gjykata e shkallës së dytë e refuzoi ankesën e paditësit sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadiës dhe e vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në këtë pjesë për arsye se sipas dispozitës së nenit 154 të Ligjit për Marrëdhënie Detyrimore parashihet se kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij. Ndërkaq sipas

dispozitës së nenit 266 të njëjtit ligj parashihet se kreditori ka të drejtë në kompensim të dëmit të zakonshëm dhe të dobisë së munguar, që debitori është dashur të parashikonte në kohën e lidhjes së kontratës si pasojë të mundshme të shkeljes së kontratës e duke marrë parasysh faktet të cilat i ka pasur të njohura atëherë ose është dashur të kishte të njohura. Për faktin se palët me kontratë në mënyrë decidive kanë paraparë mënyrën e pagimit të mallit-neni 4 i kontratës së palëve ndërgjyqëse dhe atë 20 ditë nga dita e pranimit të mallit dhe se në mënyrë decidive është kërkuar që pagesën paditësi ta siguroj me garanci bankar që nënkupton se në rast se paditësi nuk arrin mallin e marrë të paguajë në afat prej 20 ditësh, të ketë sigurimin bankar e të cilin kusht paditësi nuk e ka respektuar gjegjësisht mallin e marrë nuk e ka siguruar me garanci bankare dhe me pagesën e mallit ka rënë në vonesë. Prandaj, rrjedh përfundimi se sipas dispozitës së nenit 4 të kontratës së partneritetit për vitin 2010-2011 afati në vështrim të dispozitës së nenit 125 të LMD paraqet kusht esencial të kontratës, për faktin se kontrata nuk është përmbushur sipas kushteve të kontraktuara dhe të pranuar nga palët me rastin e lidhjes së kontratës dhe nuk ekziston fajësia tek e paditura për shkëputjen e kontratës e cila rrethanë paraqet kusht për shpërblimin e dëmit në bazë të nenit 266 të LMD.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë vetëm në pjesën në të cilën është vërtetuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pikën I të dispozitivit (pjesën refuzuese), ndërsa në pjesën tjetër të aktgjykimit nuk e shqyrtoi pasi që në atë pjesë është prishur aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, kundër të cilës pjesë nuk mund të paraqitet revizioni.

Sipas kësaj gjendje të çështjes Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykata e shkallës së parë dhe e dytë në bazë të vërtetimit të drejt dhe të plotë të gjendjes faktike sa i përket kërkesëpadisë drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit përkatësisht refuzimit të ankesës e paditësit. Aktgjykimi nuk përmban shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat gjykata e revizionit i vlerëson sipas detyrës zyrtare.

Paditësi me revizion i përsërit dhe parashtrohet çështjen të cilat ishin vlerësuar edhe para gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë gjatë shqyrtimit të raportit juridiko-kontestues e të cilat janë vlerësuar me rastin e marrjes së aktgjykimit nga gjykata e shkallës së dytë. Lidhur me këtë në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe shkallës së dytë janë dhënë arsye të mjaftuara juridike dhe faktike të bazuara në ligj të cilat i aprovon edhe kjo Gjykatë e revizionit.

Objekt shqyrtimi në gjykatën e revizionit ishin pretendimet e revizionit përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave të LPK nga neni 214 par. 1 pika (a) dhe (b) të cilat pretendime nga kjo Gjykatë trajtohen si të pabazuara, ngase aktgjykimet nuk përfshihen me të meta e paqartësi përkundrazi të njëjtat janë të qarta dhe përbëjnë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet juridikisht të vlefshme për gjykimin të drejtë të kësaj çështje juridike të cilat janë të pranueshme plotësisht edhe për gjykatën e revizionit.

Pretendimet tjera të parashtruara në revizion se e paditura-kundërpaditësja i ka sjellë mall paditësit në sasi më të madhe se sa është kërkuar, se një pjesë e mallit është asgjësuar nga inspekcioni i tregut si dhe shuma prej 7.610.37 € është borxh i personit H. K., Gjykata Supreme i vlerëson si irelevante sa i përket vendosjes për kërkesën nga padia, për këto pretendime eventualisht mund të jenë relevante me rastin e vendosjes sipas kërkesës nga kundërpadia. Prandaj, nga këto arsye pretendimet e tilla nuk patën ndikim në marrjen e çfarëdo vendimi tjetër.

Pasi që aktgjykimi i goditur me revizion nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, kurse në gjendjen faktike të vërtetuar drejt, drejt është aplikuar e drejta materiale Gjykata Supreme në kuptim të nenit 222 të LPK, e refuzoi revizionin e paditësit-kundër paditurit si të pabazuar duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Kryetari i kolegjit,
Isa Kelmendi